



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
DREJTORIA E AUDITIMIT

Nr. 1857/prot.

Tiranë, më 8 . 5 .2023

MIRATOI
DREJTORI I AUDITIMIT
LULJETA NANO



PROGRAM I ANGAZHIMIT TË AUDITIMIT

**PËR AUDITIMIN E AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË E
INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR**

Në zbatim të planit të auditimeve për vitin 2023, i miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm me shkresën nr. 5793, datë 20.10.2022, Drejtoria e Auditimit do të angazhohet në një mision auditimi.

Objekti i auditimit:

Auditim i shërbimeve të sigurisë në institucionin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, nëpërmjet auditimit në bazë sistemi, vlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe të vlerësimit të saktësisë, plotësisë, ligjshmërisë së veprimeve financiare dhe të besueshmërisë së sistemit financiar.

Lloji i auditimit:

Auditim financiar.

Subjekti i audituar:

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

Qëllimi i auditimit:

Të ndihmojë Autoritetin Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, në realizimin e objektivave të veprimtarisë së saj, duke përmirësuar sistemet e menaxhimit dhe të kontrollit dhe të vlerësojë nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar.

Metoda e auditimit:

Auditimi në bazë sistemi, duke përdorur si metoda dhe teknika, intervista, pyetësor, rishikim të dokumentacionit, analiza, ekzaminim kryq, testim i detajuar, etj.

Baza ligjore:

- Ligji nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik” i ndryshuar.
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
- Ligji nr.10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”.
- Ligji nr.8457, datë 11.2.199 “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret Shtetëror’” i ndryshuar.
- Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.
- Ligji nr.115/2021 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2022” dhe Ligji nr. 84/2022 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2023”.
- VKM nr. 187, datë 8.3.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike “ i ndryshuar.
- VKM Nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” i ndryshuar.
- VKM nr.929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar.
- VKM nr. 717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës në institucionet buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”.
- VKM nr. 234, datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe të punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”.
- VKM nr. 673, datë 02.09.2020 “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë.
- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të qeverisjes së përgjithshme”,
- Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe të Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të qeverisjes së përgjithshme”,
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.
- Udhëzimet e Ministrit të Financave për procedurat e hartimit të projekt buxheteve afatmesme, të zbatimit të buxheteve vjetore si dhe procedurat standarde të monitorimit të buxhetit.
- Rregullorja e Brendshme e funksionimit të institucionit.
- Standardet Ndërkombëtare i Praktikave Profesionale të Auditimit të Brendshëm të Institutit të Audituesve të Brendshëm.
- Manuali i Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik.
- Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
- Si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore dhe nën ligjore që lidhet me veprimtarinë e subjektit dhe misionin e auditimit.

Periudha që do të auditohet: Auditimi do të kryhet për 01.01.2022 – 31.3.2023.

Afati i auditimit : Auditimi do të fillojë me datë 8.5.2023 dhe do të përfundojë me datë 12.6.2023.

Grupi i auditimit: Luljeta Nano - Përgjegjëse grupi
Engjellushe Ibraliu- Anëtar

Drejtimet e auditimit :

I. Auditimi i sistemit të kontrollit të brendshëm.

1.Vlerësimi i komponentëve të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Vlerësimi i mjedisit të kontrollit, menaxhimit të riskut, kontrollit të aktiviteteve dhe sistemi i informim komunikimit e monitorimi.

II. Auditimi i sistemit të hartimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit.

- 1.Vlerësimi i procedurave të ndjekura për programimin e nevojave, përgatitjen e projektbuxhetit afatmesëm dhe planit vjetor të buxhetit.
2. Vlerësimi i procedurave të zbatimit të buxhetit, raportimit dhe monitorimit të performancës buxhetore.

III. Auditimi i sistemit të pagave.

1. Zbatimi i dispozitave ligjore për pagat, shtesat mbi pagë e llogaritjet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve.
2. Respektimi i strukturës organizative, organikës dhe limiteve të miratuara sipas kuadrit rregullator.
3. Zbatimi i procedurave të përgatitjes së listë pagesave.
4. Vlerësimi i rregullshmërisë së kontabilizimit të pagave dhe sigurimeve shoqërore.

IV. Auditimi i sistemit të pagesave, administrimit, inventarizimit, ruajtjes dhe lëvizjes së aktiveve qarkulluese dhe të qëndrueshme .

1. Vlerësim i ligjshmërisë së kryerjes së pagesave nëpërmjet bankës, arkës për shpenzimet operative administrative si dhe kontratave të shërbimeve, mallrave dhe investimeve dhe likuidimi i pagesave bazuar në dokumentacion justifikues.
 2. Zbatimi i kuadrit rregullator në marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara.
 3. Auditimi i procedurave të menaxhimit, administrimit, vlerësimit, ruajtjes së aktiveve.
- Vlerësim i sistemit të kontrollit periodik të aktiveve.
4. Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve në magazinë e përdorim, rakordimi me kontabilitetin.

5. Auditimi i disponibilitetit të fondeve buxhetore për financimin e zbatimit të projekteve të ndryshme, të investimeve, apo shërbimeve, verifikimi i regjistrit të prokurimeve (disponibiliteti i fondeve) mallra shërbime, punë të depozituar pranë Degës së Thesarit.

V. Auditimit i sistemit të kontabilitetit dhe raportimit financiar.

1. Mbajtja e kontabilitetit, zbatimi i procedurave në përgatitjen e pasqyrave financiare plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

3. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

VI. Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

Të tjera probleme që dalin gjatë angazhimit të auditimit lidhur me zbatimin e programit të angazhimit të auditimit.

GRUPI I AUDITIMIT

Luljeta Nano



Engjellushe Ibraliu

